

VENDIM  
Nr.632, datë 11.6.2009

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË KULLOTAVE DHE LIVADHEVE  
PËR KULLOTJE DHE KOSITJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 1, e 17, pika 5 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi nr.887, datë 19.12.2007 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”, shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
Sali Berisha

Tabela e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje

a) Tarifat e kullotjes së bagëtive:

| Nr. | Lloji i bagëtive | Tipi i kullotës        |                      | Pyje që kulloten<br>Lekë/krerë |
|-----|------------------|------------------------|----------------------|--------------------------------|
|     |                  | Dimërore<br>lekë/krerë | Verore<br>lekë/krerë |                                |
| 1.  | Dhen             | 100                    | 100                  | 50                             |
| 2.  | Dhi              | 100                    | 80                   | 100                            |
| 3.  | Gjedh            | 800                    | 800                  | 60                             |
| 4.  | Njëthundrak      | 800                    | 800                  | 60                             |

b) Tarifat e kositjes së barit dhe krasitjes së drurëve pyjorë për gjedhe:

| Nr. | Emërtimi        | Tipi i kullotës                 |                               | Pyje që kulloten<br>lekë/dru |
|-----|-----------------|---------------------------------|-------------------------------|------------------------------|
|     |                 | Dimërore<br>lekë/m <sup>2</sup> | Verore<br>lekë/m <sup>2</sup> |                              |
| 1.  | Kositje bari    | 0                               | 1                             | 10                           |
| 2.  | Krasitje gjethi | 0                               | 0                             | 10                           |

c) Tarifat vjetore të përdorimit të sipërfaqes së tokës për ndërtimet provizore në fondin kullosor nga fermerët që mbarështojnë bagëti:

| Nr. | Lloji i ndërtimit | Tipi i kullotës |        | Pyje që kulloten |
|-----|-------------------|-----------------|--------|------------------|
|     |                   | Dimërore        | Verore |                  |

|    |                            | lekë/m <sup>2</sup> /vite | lekë/m <sup>2</sup> /vit | lekë/m <sup>2</sup> /vit |
|----|----------------------------|---------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 1. | Qendër stani e rrethuar    | 50                        | 50                       | 50                       |
| 2. | Qendër përpunim bulmeti    | 100                       | 100                      | 100                      |
| 3. | Ngrehinë banimi për barinj | 50                        | 50                       | 50                       |
| 4. | Mullinj, magazina          | 100                       | 100                      | 100                      |